



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 74/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.D kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.M, për shkak të anulimit të vendimit nr. V_955_2018 të datës 29.03.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 17.10.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 24.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V_955_2018 të datës 29.03.2018, të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V_955_2018 të datës 29.03.2018, si jo i ligjshëm, me arsyetimin se fatura e lartë në vlerën prej 525.02 euro është rezultat i pamundësisë së leximit të njësorit për afërsisht prej 3 muajve e jo siç pretendon DMK-ja e ZRRE-së se njëtori ka mundur me pas çrregullime dhe ku merr për kriter mesataren e muajve paraprak. Gjithashtu ka theksuar se paditësi me datë 01.03.2016 ka dërguar tek konsumatori ekipin për ta konstatuar gjendjen reale në teren dhe në procesverbalin nr. 0666134 është konstatuar se njëtori ka qenë në gjendje të rregullt teknike. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe një fjalën përfundimtare ka deklaruar se shpenzimi i faturuar në muajin shkurt 2016 është shpenzim i bërë për 3 muajt paraprak si rezultat i pamundësisë së matjes dhe se në rast të shpërndarjes së shpenzimit për 3 muaj atëherë shpenzimi mesatar për 1 muaj do të ishte $A1 = 81.66 \text{ kWh}$ dhe $A2 = 507 \text{ kWh}$ që është shpenzim i përafërt me shpenzimin e muajit gusht 2017. Gjithashtu ka shtuar se

konsumatori me datë 26.02.2019 ka bërë kërkesë për pasivizim të njehsorit ndërsa më datën 04.03.2019 ekipet e KEDS sipas kërkesës së konsumatorit e kanë shkyçur njehsorin në fjalë dhe se nga data 07.03.2019 ky njehsor nuk ka pasur shpenzim, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovet padia e paditësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurit ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i Bordit të ZRRE-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë pasi që fatura prej 525.02 euro nuk mund të jetë e saktë pasi që shpenzimet që ka bërë paditësi më vonë për tërë vitin janë rreth 1,000 kWh më pak se sa vetëm shpenzimi i faturuar në periudhën 02/2016. Gjithashtu ka theksuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me nenin 17 të rregullores për shkyçje dhe rikyçje pasi që me datë 18.03.2016 paditësi nuk ka bërë inspektim si pretendon, por nga procesverbali konstatohet se ka bërë shkyçjen e konsumatori edhe pse i njëjti e ka kontestuar borxhin. Në fund ka theksuar se ZRRE ka gjetur se asnjë parametër nuk tregon që konsumatori të këtë shpenzuar këtë sasi të energjisë dhe se punëtorët e autorizuar të paditësit e kanë pasur për obligim të bëjnë shqyrtimin e saktësisë sa i përket gjendjes teknike të njehsorit dhe se nga lista e leximit për periudhën 10.2015, 11.2015 dhe 12.2015 punëtorët e autorizuar të paditësit kanë dhënë dy arsytim, atë se njehsori është brenda dhe nuk kanë qasje si dhe arsyetimin se njehsori nuk ka shpenzime, andaj gjykatës i ka propozuar padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Formulari i ankesës së konsumatorit L.U 29.02.2016, procesverbal - raport mbi ndërrimin dhe heqjen e njësorit elektrik nr.0199453 i datës 20.11.2015, Kërkesë e datës 29.02.2016, transaksionet e konsumatorit L.U për periudhën 31.12.2015-06.03.2016, procesverbal nr.0666134 i datës 01.03.2016, formulari i ankesës së konsumatorit L.U i datës 13.11.2017, vendim DMK V1593-07-2017 i datës 07.07.2017, kundërshtim i KESCO nr.1968 i datës 29.08.2017, kalkulim për korrigjimin e energjisë së shpenzuar nr.134847, vendim i ZRRE V_955_2018, vendim i KESCO i datës 23.05.2016, procesverbal 1446248 i datës 18.03.2016, kontratë për shitjen dhe bartjen e pronës nr.5387 e datës 30.06.2014, kërkesë e konsumatorit L.U e datës 03.03.2016, formular i ankesës së konsumatorit i datës 28.10.2014, prerja e borxhit për konsumatorin e privatizuar e lëshuar nga KEDS për konsumatorin nr.DMI9005139, kontratë mbi qiranë e datës 15.02.2016, komunikim me email i datës

29.10.2014, procesverbal nr.1619250 i datës 19.05.2016, komunikim me email në mes të ZRRE dhe KESCO i datës 04.07.2017-11.07.2017, faturat e konsumatorit L.U, procesverbal nr.0903362 i datës 04.03.2019, formulari i ankesës së konsumatorit dt.26.02.2019, transaksionet e konsumatorit për periudhën 31.12.2018-07.03.2019, transaksionet e konsumatorit L.U për periudhën 31.07.2002-07.03.2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Gjykata konstatoi se konsumatori L.U me shifër DMI-9005139 me datë 20.02.2016 nga paditësi kishte pranuar faturën mujore për periudhën 02/2016 me shpenzim prej 3,979 kWh apo llogaritur në vlerë financiare, faturën në shumë prej 525.02€.

Mbi këtë bazë konsumatori L.U parashtron ankesë me datën 29.02.2016 tek paditësi, të cilët me vendimin e datës 23.05.2016 i refuzojnë ankesën konsumatorit me arsyetimin se në bazë të inspektimit në vend të ngjarjes ka rezultuar se njehsori elektrik dhe kabllot furnizues kanë qenë në rregull. Kundër këtij vendimi, konsumatori L.U me datë 24.05.2016 ka parashtruar ankesë tek i padituri.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK-së) me vendimin DMK V_1593_07_2017 i datës 07.07.2017 ka aprovuar ankesën e konsumatorit L.U, dhe ka obliguar KES/CO që konsumatorin me shifër 9005139 ta shkarkon nga fatura e muajit 02/2016 me nr. 02160DMI-9005139 në vlerë financiare prej 525.02€ dhe për këtë muaj të ngarkoi konsumatorin në fjalë me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 02/2017 (TL=355 kWh dhe TU=0 kWh).

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, të cilët me Vendimin V_955_2018 të datës 29.03.2018 kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e KES/CO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin L.U me shifër të konsumatorit DPR – 9005139 dhe ka mbetur në fuqi vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1593_07_17 i datës 07.07.2017.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 15 par. 1, nën-par. 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: ... 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje*

të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë;” si dhe në kuptim të nenit 17 par. 1 që përcakton se: “1. Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara;”. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 14, 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr. 04/2017 e datës 16 mars 2017) që përcaktojnë kompetencën e DMK-së pranë ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga furnizuesi apo operatori i sistemit si dhe kompetencën e Bordit të ZRRE-së për vendosjen për ankesat ose kontestet ndaj vendimeve të DMK-së.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Nga prova formulari i ankesës i datës 29.02.2016 dhe kërkesë e datës 29.02.2016 gjykata ka konstatuar se konsumatori L.U ka kërkuar nga paditësi kontrollimin e njehsorit për shkak të matjes jo të saktë pasi që kishte pranuar faturën në shumë prej 525.02€ dhe kishte pretenduar se njehsori sapo ishte instaluar ndërsa lokali për atë periudhë nuk ka funksionuar.

Nga prova procesverbal - raport mbi ndërrimin dhe heqjen e njësorit elektrik nr.0199453 i datës 20.11.2015, gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ashtu që tek konsumatori L.U është bërë instalimi i njehsorit nr. 64673625 dhe gjendja e shpenzimit në momentin e instalimi ka qenë 0 në të dy tarifat.

Nga prova procesverbal nr.0666134 i datës 01.03.2016, gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë verifikimin e gjendjes së tarifave tek konsumatori dhe ka konstatuar se tarifa A1 ka harxhim 2599 dhe tarifa A2 ka harxhim 1643, ndërsa tek pjesa e komenteve ka konstatuar se tarifa e dytë nuk ka harxhim.

Nga prova procesverbal nr. 1446248 të datës 18.03.2016 gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë shkyçjen e konsumatorit për shkak të borxhit ndaj KEDS me shumë prej 550.09€.

Nga prova procesverbal nr.1619250 i datës 19.05.2016 gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë verifikimin njehsorit tek konsumatori dhe ka konstatuar në procesverbal se njehsori është i bllobuar, hyrjet dhe daljet janë në rregull dhe pas kontrollit njehsori mbetet i bllobuar.

Nga provat faturat e konsumatorit dhe transaksionet e konsumatorit për periudhën, gjykata ka konstatuar se konsumatori L.U në periudhën kontestuese, përkatësisht në muajin 11/2015, 12/2015, 01/2016, 02/2016 është regjistruar konsumi i energjisë sipas matjes elektrike me matës ashtu që për periudhën 11/2015, 12/2015 dhe 01/2016 ka nuk ka pasur shpenzim, ndërsa për periudhën 02/2016 ka regjistruar shpenzim ne tarifën A1 2,456 kWh dhe T2 = 1,523 kWh apo shuma e përgjithshme prej 525.02€.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me faktin se është obliguar KES/CO që konsumatorin me shifër DMI-9005139 ta shkarkon nga fatura e muajit 02/2016 (fatura nr. 02160DMI-9005139) në vlerë financiare prej 525.02€ dhe për këtë muaj të ngarkoi konsumatorin në fjalë me shpenzimet e energjisë elektrike si të muajit 02/2017 (TL=355kWh dhe TU=0kWh).

Gjykata vlerëson se korigjimi i bërë nga paditësi është në kundërshtim me Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017, 13 prill 2017) në nenin 5 par. 1, pika 1.5 që përcakton se: *“1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja;”* dhe në pikën 1.6. përcakton se: *“marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim, që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.”*

Gjithashtu në nenin 28 par. 1, 2 dhe 3 përcaktohet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuar nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit nr. ZRRE/DMK_V_1593_07_2016 të datës 07.07.2017.

Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit se shpenzimi i regjistruar në muajin 02/2016 në tarifën A1 2,456 kWh dhe T2 = 1,523 kWh apo shuma e përgjithshme prej 525.02€ është shpenzim i bërë në muajt paraprak për shkak të pamundësisë së leximit të njehsorit elektrik ashtu që ky shpenzim duhet shpërndarë në 3 muajt paraprak, janë në kundërshtim me provat e administruar, përkatësisht me provën faturat e konsumatorit.

Nga kjo provë, gjykata konstatoi se konsumatori është faturuar për shpenzimin e energjisë sipas matjes, pra nuk është faturuar me vlerësim (E apo paushall). Në rast se qasja nuk do ishte e mundur për matje nga punëtorët e autorizuar të KESCO, konsumatori do të faturuhej me vlerësim (E), por në këtë rast nga prova faturat e konsumatorit bëhet e qartë se konsumatori është faturuar për shpenzimin e energjisë së matur me matës dhe në këtë rast në muajt 11/2015, 12/2015 dhe 01/2016 ka nuk ka pasur shpenzim, andaj gjykata gjeti se një argument i tillë nuk ka mbështetje në provat e administruara.

Gjykata e vlerëson si të drejtë arsyetimin e ZRRE kur ka konstatuar se kilovatët e faturuar konsumatorit në pikën matëse 64673625 ka mund të jetë si pasojë e ndonjë çrregullimi të mundshëm të pajisjes matëse për faktin se nuk ka asnjë parametër që konsumatori ka mundur të shpenzoj një sasi prej 3,979 kWh apo në lartësi prej 525.02€ pasi që nga analizimit i transaksioneve të konsumatorit, faturave të konsumatorit L.U rezulton se konsumatori nuk ka pasur shpenzim të tillë as të përafërt të energjisë elektrike në ndonjë periudhë para ndërrimit të njehsorit elektrik e as pas ndërrimit të njehsorit elektrik, si dhe shpenzimet që ka bërë paditësi më vonë për tërë vitin janë rreth 1,000 kWh më pak se sa vetëm shpenzimi i faturuar në periudhën 02/2016, për çfarë gjykata nuk mund që ti falë besimin pretendimeve të paditësit lidhur me këtë rrethanë.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në këtë çështje, si kontratë për shitjen dhe bartjen e pronës nr.5387 e datës 30.06.2014, formular i ankesës së konsumatorit i datës 28.10.2014, prerja e borxhit për konsumatorin e privatizuar e lëshuar nga KEDS për konsumatorin nr.DMI9005139, kontratë mbi qiranë e datës 15.02.2016, komunikim me email i datës 29.10.2014, formulari i ankesës së konsumatorit dt.26.02.2019, transaksionet e konsumatorit për periudhën 31.12.2018-07.03.2019, por vlerësoi se të njëjtat ishin prova lidhur me fshirjen e borxhit pas privatizimit si dhe lidhur me shkyçjen e konsumatorit nga

rrjeti por të njëjtat nuk ishin relevante me çështjen kontestuese të faturës për periudhën 02/2016 dhe me ndikim për vendosje ndryshe.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.74/22, datë 24.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.